



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27 regjistër (JR)
Datë 04.07.2023

Nr. 60 i vendimit
Datë 23.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, ditën e mërkurë, më datë 23.07.2025, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 27/2023, datë 04.07.2023, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 660, datë 16.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës; Aneksi i Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe Kodi i Procedurave Administrative.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 660, datë 16.05.2023, dhe përfundimin e gjykimin pa një vendim përfundimtar, të konfirmuar në parashtrime e bisedimet përfundimtare, pas kalimit procedural, edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si dhe pasi analizoi parashtrimet e subjektit të

rivlerësimit, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998” dhe të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Referuar vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit plotësoi detyrimet që rridhnin nga nenet 33 – 44 të ligjit nr. 84/2016, duke dorëzuar deklaratat në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”)¹.
3. Znj. Majlinda Andrea ka ushtruar detyrën e gjyqtares nga vitit 1992. Nga data 28.07.2008² deri më datë 14.06.2017, ajo ka qenë edhe anëtare e gjykatës në Gjykatën e Lartë. Për shkak se në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 76/2016”), gjendej në këtë detyrë [nuk kishte një akt që i hoqi këtë cilësi], në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, Komisioni e konsideroi subjekt të ligjit nr. 84/2016 dhe ia nënshtrroi procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Pas analizës së situatës faktike-ligjore dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni arriti në konkluzionin se znj. Majlinda Andrea është subjekt rivlerësimi, pasi mban statusin e magjistratit, dhe ia nënshtrroi rivlerësimit *ex officio*, duke vlerësuar vetëm kriterin e kontrollit të figurës. Për shkak se subjekti i rivlerësimit është dënuar për veprën penale “*korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, Komisioni vlerësoi se subjekti ka cenuar rëndë besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe në mbështetje të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 660, datë 16.05.2023, e shkarkoi nga detyra. Arsyetimi i Komisionit në mënyrë të përmbledhur bazohet në sa vijon:

4.1. Komisioni konstatoi se: (i) subjekti është e dënuar me një vendim penal të formës së prerë; (ii) duke qenë se nuk ka një akt të organit kompetent që e mbaron statusin, ai [Komisioni] duhet të shprehet lidhur me statusin e magjistratit dhe statusin juridik të subjektit në raport me funksionin që ka pasur, si dhe të kryejë procesin e saj të rivlerësimit; (iii) dënimi me një vendim penal të formës së prerë, përpos se përbën shkak për mbarimin e statusit të magjistratit, përbën edhe një element të qenësishëm të cenimit të besimit të publikut, në këndvështrim të nenit 61,

¹ Sipas shënimit në vendimin e Komisionit, pasi nuk janë pjesë e fashikullit në Kolegj.

² Me vendimin nr. {***}, datë 28.07.2008, të dhe Dekretin e Presidentit të Republikës nr. {***/2008.

pika 5 e ligjit nr. 84/2016; (iv) dënimi penal sjell në mënyrë automatike mbarimin e statusit të magjistratit dhe për efekt të procesit të rivlerësimit, passjell shkarkimin nga detyra.

4.2. Referuar Kodit të Etikës së Gjyqtarëve, Parimeve të Bangalores dhe Opinionit nr. 3 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, vazhdimi i gëzimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me qëllimin dhe parashikimin e nenit 179/b të Kushtetutës. Dënimi i subjektit për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, referon që subjekti ka cenuar rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

5. Për sa i përket hetimit administrativ të kryer në Komision, nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se me parashtrimet e datës 15.05.2023, nëpërmjet avokates A. S.³, subjekti i rivlerësimit pretendoi se:

5.1. Komisioni nuk ka kompetencë lëndore për të rivlerësuar një subjekt statusi i të cilit ka përfunduar *de facto* dhe nuk mund të zëvendësojë kompetencat e organeve të tjera të drejtësisë, qoftë edhe për shkak të faktit se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 ajo ishte e pezulluar nga detyra. Në këtë mënyrë, subjekti pretendoi se është e përjashtuar *de facto* nga sistemi i drejtësisë, pavarësisht se nuk ka akt të organit kompetent. Subjekti pretendoi se e ka humbur statusin e magjistratit në momentin që Gjykata e Lartë ka shpallur vendin e saj vakant dhe e zëvendësoi me një anëtar të ri dhe nuk e gëzon *de facto* statusin e magjistratit, pasi nuk gëzon privilegjet e as detyrimet e këtij statusi.

5.2. Fakti që organet e tjera në sistemin e drejtësisë nuk vepruan për të ndërmarrë procedurat e nevojshme të parashikuara në ligj, sipas saj, nuk e bën Komisionin kompetent për të rivlerësuar një subjekt, statusi i të cilit ka përfunduar.

5.3. Mospasja e kompetencës *ligjore*, për të marrë masa administrative, cenon nenin 6 – në aspektin e gjykatës së caktuar me ligj dhe nenin 8 të KEDNj-së – në kuptimin që ndërhyrja në jetën private të individit, siç Komisioni kërkon të vendosë në rastin e saj, dhe procesi, duhet të kryhet nga një organ kompetent.

5.4. Zgjidhja e drejtë ligjore, sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të ishte përfundimi i procedurës pa një vendim përfundimtar.

III. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit të Komisionit, ushtroi ankim Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit dhe deklarin e përfunduar të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ka humbur statusin e magjistratit. Gjithashtu, kërkon që Kolegji të investohet e të kërkojë informacion rreth arsyeve përse organet përgjegjëse nuk morën një vendim apo nëse kanë marrë një vendim nga komunikimi i fundit i Komisionit. Komisioneri Publik, e mbështet ankimin në argumentet si vijon.

³ Sipas prokurës së posaçme, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2022.

6.1. Komisioni, në interpretim të gabuar të nenit 140/2/b të Kushtetutës, ka konsideruar se znj. Majlinda Andrea gëzon statusin e magjistratit e, për rrjedhojë, të subjektit të rivlerësimit kalimtar.

6.2. Në interpretim të gabuar të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, Komisioni e konsideroi si një shkak që lejon juridiksionin e jashtëzakonshëm disiplinor (rivlerësimi kalimtar) si lejim i shqyrtimit në themel të procedurës së rivlerësimit, duke e kategorizuar ekzistencën e saj, si një ndër rastet kur shkarkimi nga detyra i magjistratit kryhet bazuar në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

6.3. Juridiksioni kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit *do të duhet* të ushtrohet për të hetuar se cilat kanë qenë *eventualisht* shkaqet e prezumuara ligjore, që sollën si pasojë mosveprimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) e, për pasojë, edhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), dhe inicimin e hetimit dhe procedimit disiplinor ndaj një magjistrati, ndaj të cilit u dha një vendim i formës së prerë për kryerjen e një krimi. Ky hetim, sipas Komisionerit, është i nevojshëm për të verifikuar edhe nëse, eventualisht, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nga korrespondenca shkresore e Komisionit me ILD-në dhe KLGj-në, që daton janar 2022, deri në zhvillimin e seancës dëgjimore në Komision, maj 2023, ILD-ja dhe KLGj-ja të kenë ushtruar detyrimin e tyre kushtetues.

6.4. Në rast se, edhe gjatë hetimit të Kolegjit, për shkak të gjykimit të këtij ankimi, rezulton se institucionet që Kushtetuta i ngarkon me kompetencën e përmbushjes së juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues janë ende në kushtet e mosveprimit, edhe për shkak të rolit kushtetues të parashikuar nga paragrafi 5 i nenit 179/b i Kushtetutës, zbatimi i drejtpërdrejt nga ana e Kolegjit i dispozitës së nenit 140/2/a të Kushtetutës, për efekt të kryerjes së procesit të rivlerësimit, do të duhet të sjellë të njëjtën pasojë, deklarimin e përfunduar të procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

IV. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, për të cilin Komisioneri Publik, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e

ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi në Kolegj, i ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 660, datë 16.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zhvillohet në seancë gjyqësore publike.

9.1. Për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme⁴. Në seancën publike të zhvilluar në datën 14.07.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, u përfaqësua, sipas autorizimit nr. {***} prot., datë 09.07.2025, nga prokurori Klodjan Braho. Ky i fundit, kërkoi nga Kolegji të verifikohet nëse për subjektin e rivlerësimit ka një vendim për mbarimin e statusit, marrë pasi është depozituar ankimi. Po ashtu, z. Braho potencoi që, pasi Kolegji të marrë në konsideratë shkaqet e ankimit, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 660, datë 16.05.2023, të Komisionit, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit dhe të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ka humbur statusin e magjistratit. Z. Braho argumentoi se nëse rezulton që këto institucione janë ende në kushtet e mosveprimit, do të duhet që procesi i rivlerësimit të deklarohet i përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

9.2. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit në seancat përgjatë gjykimit në Kolegj, ndërsa dorëzoi parashtrimet e saj me shkrim. Në parashtrime, subjekti shprehu dakordësinë me ankimin e Komisionerit Publik dhe kërkoi ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit dhe deklarimin e përfunduar të procesit të rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar, në përputhje me nenin 179/b të Kushtetutës dhe praktikën përkatëse të Kolegjit, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit. Subjekti pretendon se rrethanat e dënimit penal të formës së prerë të një magjistrati nuk përbëjnë shkak për rivlerësim në themel, por për ndërprerje të procesit të rivlerësimit, për shkak të humbjes së objektit dhe mungesës së një marrëdhënieje ligjore⁵. Sipas subjektit, ky standard i Kolegjit shmang çdo tendencë për tejkalim apo zëvendësim të juridiksionit të zakonshëm disiplinor nga ana e juridiksionit të jashtëzakonshëm të rivlerësimit kalimtar.

9.3. Kolegji çeli hetimin dhe administroi përgjigjen e KLGj-së, më datë 15.7.2025, në të cilën konfirmohet mungesa e një vendimi nga ana e këtij organi. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit edhe gjatë paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare, pavarësisht se mori dijeni për datën dhe orën e seancës. Nga ana tjetër, z. Braho deklaroi se fakti që KLGj-ja është shprehur se nuk ka një vendim për përfundimin e statusit të magjistratit për znj. Majlinda Andrea, do të thotë që institucionet e juridiksionit të zakonshëm disiplinor kushtetues nuk kanë ushtruar kompetencat e kryerjes së hetimit dhe procedimit disiplinor me qëllim shkarkimin e subjektit të rivlerësimit dhe humbjen e statusit të magjistratit e, për rrjedhjë, janë në kushtet e mosveprimit. Për këto shkaqe, ai i kërkoi përfundimisht Kolegjit të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 660, datë

⁴ Në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

⁵ Subjekti referoi vendimet e Kolegjit (JR) nr. 32/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Ibrahim Hoxha dhe (JR) nr. 29/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri.

16.05.2023 dhe të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për znj. Majlinda Andrea pa një vendim përfundimtar, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit për themelin e çështjes

10. Pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe përgjigjen zyrtare nga KLGj-ja, që mban datën 15.07.2025, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi objekt kontrolli i Komisionit është marrë në zbatim të ligjit dhe duhet të lihet në fuqi. Në kushtet që për subjektin e rivlerësimit organet përgjegjëse vazhdojnë të jenë në kushtet e mosveprimit për deklarimin e mbarimit të statusit për të, është i drejtë vlerësimi i kryer nga Komisioni, duke vijuar me marrjen e një vendimi në kuadër të procesit të rivlerësimit. Mosveprimi i organeve përgjegjëse, konstatuar gjatë periudhës kohore kur Komisioni mori vendimin objekt ankimi, vijon edhe në kohën kur Kolegji zhvilloi procesin gjyqësor, në seancë gjyqësore publike.

10.1. Për këto arsye, vendimi i Komisionit ka qenë zgjidhja e duhur e situatës ligjore e faktike në kushtet e ekzistencës së një dënimi penal të formës së prerë, edhe duke mbajtur në konsideratë qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

10.2. Nga ana tjetër, shkaqet në të cilat është bazuar vendimi i Komisionit objekt ankimi nuk janë kontestuar nga subjekti, qoftë në drejtimin e arsyetimit apo bazën ligjore, cenimin e besimit të publikut nga subjekti, nën dritën e dënimit penal të marrë për të, pas një vendimi fajësie të formës së prerë, përcaktuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

11. Pasi analizoi sa referuar më sipër dhe kërkimet e palëve, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se vendimi i Komisionit bazohet në analizën e kryer pas verifikimit të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ.

11.1. Konkretisht, Komisioni ka konstatuar i se znj. Majlinda Andrea është deklaruar fajtores dhe është dënuar me 4 (katër) vjet burgim, me vendimin e formës së prerë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 25, datë 14.06.2017, për veprën penale të “*Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të konvertuar në shërbim prove, si dhe i është hequr e drejta për të kryer funksione publike për një afat prej 5 (pesë) vjetësh.

11.2. Këtë vendim, znj. Majlinda Andrea e ka kundërshtuar edhe pranë Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 12, datë 24.04.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. E thënë ndryshe, ky vendim e ka kaluar edhe testin e kushtetutshmërisë dhe është lënë në fuqi.

11.3. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për informacion⁶ për statusin e magjistrates për znj. Majlinda Andrea dhe të një vlerësimi për këtë aspekt, për efekt të rivlerësimit përfundimtar, më datë 18.11.2022, KLGj-ja ka informuar se nuk rezulton vendimmarrje, përfshirë edhe nga KLD-ja. KLGj-ja i ka vënë Komisionit në dispozicion fashikullin e KLD-së, me aktet në të cilët është trajtuar shkresa e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, që informonte KLD-në dhe Ministrin e Drejtësisë me vendimin penal për znj. Majlinda Andrea, dhe kërkesa e tij që organet kompetente të deklaronin përfundimin e mandatit të saj pranë Gjykatës së Lartë, sipas parashikimeve të nenit

⁶ Shkresa e Komisionit nr. {***} prot., datë 15.11.2022, “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”.

139⁷ të Kushtetutës dhe të nenit 160/1/ç⁸ të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”). Në fashikull gjendet edhe vendimi nr. 34/2017, i Gjykatës Kushtetuese (§30)⁹.

11.4. Nga aktet në fashikull rezulton se Ministri i Drejtësisë, më datë 21.06.2017, është shprehur se nuk kishte kompetencë për iniciimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe ia ka përcjellë kërkesën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë për trajtim KLD-së¹⁰.

11.5. Në mbledhjen e datës 17.7.2017, në të cilën është trajtuar kjo çështje, KLD-ja nuk e miratoi kërkesën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Sipas procesverbalit të mbledhjes, KLD-ja nuk ka deklaruar të përfunduar statusin e magjistrates për znj. Andrea, duke argumentuar që propozimi për shkarkim, në kuptim të germës “c” të pikës 1 të nenit 160 të ligjit nr. 96/2016¹¹, duhej të paraqitej nga Ministri i Drejtësisë.

11.6. Komisioni kërkoi informacion edhe nga institucioni i Presidentit të Republikës¹². Në përgjigje, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit informoi se korrespondenca e fundit mban datën 03.08.2017, duke konfirmuar se nuk ka qëndrim rreth statusit, dhe dërgoi praktikën shkresore, pa një qëndrim rreth statusit për znj. Majlinda Andrea.

11.7. Ndërsa Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën e datës 24.1.2022, ka informuar Komisionin se për magjistraten Majlinda Andrea, deri më datë 21.1.2022, nga ana e tij, nuk është nisur hetim disiplinor dhe nuk është paraqitur kërkesë për procedim disiplinor pranë KLGj-së, për marrjen e masës së “shkarkimit nga detyra”.

12. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje disa fakte kontrolluese në rrethanat faktike konkrete të sipërreferuara. *Së pari*, subjekti i rivlerësimit e fitoi cilësinë e magjistrates për shkak se ka ushtruar pa ndërprerje detyrën e gjyqtarës, duke filluar nga viti 1992. Në periudhën kohore nga viti 2008 e deri më datë 14.06.2017, ajo ka qenë e emëruar si anëtare e Gjykatës së Lartë. Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kushtetutës, në datën 11.08.2016, subjekti i rivlerësimit ishte e pezulluar nga detyra. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim të datës

⁷ “[1.] Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron në rastet e mëposhtme: [...] ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës; [...]”.

⁸ “[1.] Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: [...] ç) pezullon gjyqtarët, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj; [...]”. Në shkresë prezumohet një gabim material, pasi Kryetari i Gjykatës së Lartë citon germën “c”.

⁹ “Duke i vlerësuar rregullimet ligjore të neneve 160/1 e 173/1 të ligjit në kontekstin e detyrimeve që imponon parimi i shtetit të së drejtës për respektimin e hierarkisë së akteve normative, Gjykata konstaton paraprakisht se neni 179 i Kushtetutës nuk përmban rregullim apo delegim të shprehur për ligjvënësin, lidhur me përcaktimin e kompetencave që do të ushtrojë KLD-ja në periudhën kalimtare deri në krijimin e KLGj-së. Megjithatë, Gjykata vlerëson se ky konstatim nuk mund të konsiderohet se përbën ometim kushtetues, pasi formulimi i pikës 5 të nenit 179 të Kushtetutës se “anëtarët e KLD-së e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të KLGj-së, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të KLGj-së, sipas ligjit” shpreh dhe synon të sigurojë vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, për rrjedhojë, funksionimin normal të KLD-së në periudhën kalimtare. Për sa kohë vullneti i kushtetutëbërësit ka qenë që të mos ndërpritet funksioni i KLD-së, Gjykata vlerëson se KLD-ja, ashtu si edhe organet e tjera ekzistuese kushtetuese, do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në konstituimin e plotë të organeve të reja kushtetuese dhe, në këtë kuptim, zbatimi i neneve 160/1 dhe 173/1 të ligjit, duhet të jetë në përputhje të plotë me këtë interpretim të Gjykatës, në respekt të frymës së Kushtetutës”.

¹⁰ Referuar procesverbalit të mbledhjes së KLD-së.

¹¹ “[...] c) vendos masa disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji; [...]”.

¹² Shkresë nr. {***} prot., datë 01.04.2022 “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”.

16.07.2016, e kishte pezulluara atë nga detyra meqenëse në datën 14.07.2016, për shkak të procedimit penal, emri i saj u shënua në regjistrin e njoftimeve të veprave penale.

12.1. Në përfundim të gjykimit penal, në datën 14.06.2017, subjekti u deklarua fajtores dhe u dënua me katër (4) vjet burgim, me vendim të formës së prerë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për veprën penale të *korruptionit pasiv*, të konvertuar në shërbim prove, si dhe një dënim plotësues. Këtë vendim e konfirmoi edhe Gjykata Kushtetuese¹³. Në këtë kuptim, pretendimet e subjektit se ajo gjendet në të njëjtat kushte si subjektet e rivlerësimit Shkëlqim Miri dhe Ibrahim Hoxha, nuk qëndrojnë. Për këta dy subjekte, organi kompetent kishte përfunduar statusin e magjistratit.

12.2. Në vijim, pavarësisht nga procesi i iniciuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, asnjë nga institucionet e kohës, sikurse as ato të krijuara pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, nuk rezulton të kenë marrë vendim lidhur me statusin e subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në datën 17.07.2017, me shumicë votash, rrëzoi kërkesën e datës 16.06.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet të cilës, ai i kërkonte Presidentit të Republikës [në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë] dhe Ministrit të Drejtësisë, shkarkimin nga detyra/deklarimin e përfunduar të mandatit të anëtares së Gjykatës së Lartë, për subjektin e rivlerësimit. Ministri i Drejtësisë, në shkresën drejtuar KLD-së në datën 21.06.2017, shprehej se nuk kishte kompetencë të inicionte procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve. KLD-ja rezulton ta ketë dërguar çështjen pranë institucionit të Presidentit të Republikës, me arsyetimin se si organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit të funksionarëve publikë, verifikimi i kushteve të ndalimit do t'i jepte zgjidhje situatës, në kuptim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

12.3. Nga aktet në fashikull, rezulton se Komision është informuar në janar dhe tetor 2022 se nuk ka vendimmarrje për subjektin nga KLGj-ja dhe nga institucioni i Presidentit të Republikës dhe se nuk ka një vendim për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin. *Së fundmi*, në datën 24.01.2022, edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka njoftuar se nuk ka nisur hetim disiplinor dhe as ka paraqitur kërkesë për procedim disiplinor pranë KLGj-së, për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra, për subjektin e rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea.

12.4. Kjo situatë ligjore u konfirmua edhe pas çeljes së hetimit në procesin e zhvilluar në Kolegj. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për informacion drejtuar KLGj-së, bazuar në parashtrimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në datën 15.07.2025, KLGj-ja konfirmoi se nuk ka ende një vendim për mbarimin e statusit për subjektin.

12.5. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegji vlerëson se, nën dritën e pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të pikës 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, znj. Majlinda Andrea vazhdon të jetë *de jure* subjekt rivlerësimi, pasi nuk ka asnjë vendim për përfundimin e statusit për të, ndonëse ajo nuk e gëzon këtë cilësi *de facto* prej vitit 2016 dhe pavarësisht ekzistencës së rrethanës së dënimit me vendim penal të formës së prerë dhe plotësimit të kushtit për t'u shkarkuar, sipas germës "b" të pikës 2 të nenit 140 të Kushtetutës. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *nuk* gjen zbatim neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative¹⁴, që dikton

¹³ Me vendimin nr. 12, datë 24.04.2018.

¹⁴ "Organi publik deklaroi të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, pasi qëllimi apo objekti janë bërë të pamundur.

12.6. *Së dyti*, në ndryshim nga kërkimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Komisionerit Publik, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se vendimmarrja për statusin e magjistratëve, përfshirë edhe mbarimin e tij, për çfarëdo arsyeje ligjore, është tagër qartësisht e normuar nën përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes së organeve të drejtësisë, që veprojnë mbi bazën e ndryshimeve kushtetuese të sjella nga ligji nr. 76/2016 dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Nga ana tjetër, Kolegji i Posaçëm i Apelit, gjatë mandatit të tij, ushtron detyra të përcaktuara qartë nga Kushtetuta dhe Aneksi i saj, shtjelluar në *lex specialis*, atë nr. 84/2016. Ky kuadër ligjor për procesin e jashtëzakonshëm të rivlerësimit e përjashton mundësinë e vendimmarrjes për procese të zakonshme, sikurse fitimi, ruajtja apo humbja e statusit të magjistratëve.

13. Për sa më lart, duke konstatuar se vendimi i Komisionit për t’ia nënshtuar znj. Majlinda Andrea procesit të rivlerësimit, është i drejtë, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pabazuara kërkimet e ankimit. Për rrjedhojë, nën dritën e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se vendimi nr. 660, datë 16.05.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 660, datë 16.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj Majlinda Andrea.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.07.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi